



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT

BORDI

Nr. 355 / prot
14

Tiranë më 19 / 12 / 2025

PROCESVERBAL

MBLEDHJE BORDI

(Datë, 19/12/2025)

Të pranishëm nga Bordi: Të pranishëm nga Bordi: Mentor Beqa, Alma Liço-Gjurgji, Etleva Smaçi, Simon Mirakaj, Niuton Mulleti, Laureta Roshi, Vasil Tole.

Të pranishëm nga ISKK: Çelo Hoxha (*Drejtor Ekzekutiv*), Zoica Graci (*Drejtor i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse*), Franceska Loshe (*Specialist Jurist, për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes*).

Rendi i Ditës:

1. Miratimi i planit të punës për vitin 2026
2. Shqyrtimi i kërkesës së Nënkryetares Laureta Roshi për përgjigjen e Kuvendit mbi procedurën e zgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv të ISKK
3. Miratimi për botim i librit “Dokumente për Kryengritjen e Postribës 1946–1948”
4. Të tjera

M.Beqa: Të nderuar, le të fillojmë menjëherë mbledhjen e sotme. Jeni dakord me rendin e ditës?

E.Smaci: Unë nuk jam dakord sepse nuk është miratuar buxheti. Duhet të më kishte ardhur dhe dokumenti i miratimit.

M.Beqa: Ne e kemi gjetur buxhetin të miratuar, ëshë bërë nga Bordi i mëparshëm që në prill.

E.Smaci: Unë nuk mund të pranoj që është miratuar një plan apo buxhet pa pasur një dokument. Ai fillon në prill dhe ka fazat e tij.

M.Beqa: Ato janë ezauruar dhe kemi qënë dhe në Parlament dhe kemi bërë raportimin. Tani flasim për planin e punës dhe buxhetin që e shoqëron.

L.Roshi: Në mbledhjen e kaluar paraqita një kërkesë që në dosje të përfshiheshin edhe zërat shpenzues me emrat e personave që janë paguar nga ISKK, si dhe emrat e përfituesve. Pa asnjë qëllim insinuuës, ju drejtova pyetjen nëse, si anëtarë të Bordit, përveç honorarit për mbledhjet, është përfituar ndonjë pagesë tjetër nga ISKK.

M.Beqa: Nuk mund të insinuojmë kundër anëtarëve të Bordit, transparenca mbështetet mbi fakte.

E.Smaci: Kërkesa e znj.Laureta është e vlefshme dhe do ta mbështes edhe me shkresë zyrtare. Problemi këtu qëndron në faktin se nuk po veprohet në rrugë institucionale. Nuk jam në dijeni nëse është zhvilluar mbledhja e fundvitit dhe, në këtë kuadër, pyetja ime, edhe pse jashtë rendit të ditës, është: kur të vijë muaji janar, a ka përgatitur Drejtori një analizë vjetore? Në momentin që vjen janari, Drejtori është i detyruar që këtë analizë ta paraqesë zë për zë përpara Bordit. Sot ne jemi mbledhur për buxhetin e vitit 2026, i cili përfshin miratimin e buxhetit dhe të planit vjetor.

N.Mulleti: Nga pikëpamja procedurale, dokumentet duhej të na ishin dorëzuar të paktën një javë përpara, në mënyrë që të kishim mundësinë dhe kohën t'i shqyrtonim me vëmendje.

M.Beqa: Kjo është e përcaktuar në Ligjin për Organet Kolegjiale. Në nenin 2 të ligjit parashikohet se çdo organ kolegjial ka një kryetar dhe një sekretar.

E.Smaci: Të ndalemi te pjesa e sekretarit. Ligji përcakton se sekretari zgjidhet nga Bordi, ndërkohë që ne nuk kemi zgjedhur asnjë sekretar.

M.Beqa: Nuk kemi ndjekur një procedurë të veçantë për këtë çështje, por kur është diskutuar më herët, nuk ka pasur kundërshtime. Nëse jeni dakord, mund ta përfshijmë në rendin e ditës.

E.Smaci: Kërkesat e mia i paraqes institucionalisht, nëpërmjet shkresave zyrtare.

M.Beqa: Atëherë duhet të dini se shkresat nuk u drejtohen punonjësve të ISKK-së, por Drejtorit Ekzekutiv.

E.Smaci: I jam drejtuar punonjësit vetëm për të marrë përgjigje nëpërmjet Drejtorit Ekzekutiv. Unë kërkoj që sekretari të zgjidhet nga anëtarët e Bordit me votë. Këtë do ta propozoj edhe me shkrim.

M.Beqa: Patjetër, dhe kjo çështje do të përfshihet në mbledhjen e radhës.

Ç.Hoxha: Mund të bëj një ndërhyrje?

E.Smaci: Ju nuk duhet të jeni në mbledhje, përveç rasteve kur diskutohet buxheti.

Ç.Hoxha: Unë jam i pranishëm si përfaqësues i institutit; ligji i ISKK përcakton se marr pjesë në mbledhje pa të drejtë vote.

Kryetari i Bordit citon Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe entevek publike", konkretisht nenin 3 "Zëvendësimi i përkohshëm i kryetarit dhe sekretarit" dhe nenin 6 "Thirrja e mbledhjeve".

E.Smaci: Këto nuk janë respektuar nga ana juaj dhe jemi në shkelje të ligjit.

M.Beqa: Na thoni cilat pika nuk janë respektuar.

E.Smaci: Që nga zgjedhja e sekretarit, deri te dërgimi i rendit të ditës me Drejtorin Ekzekutiv dhe jo me ne.

M.Beqa: Ligji i ISKK-së, Neni 13, e përcakton se ai merr pjesë, pa të drejtë vote, në mbledhjet e Bordit. Kjo është eksplicite dhe në asnjë moment nuk ka pasur shkelje. E vetmja shkelje është se propozimi i buxhetit në Këshillin e Ministrave nuk është bërë nga Bordi, por nga Instituti. Rasti i sekretarit është i veçantë, pasi nuk kemi bërë një zgjedhje formale.

L.Roshi: Unë mendoj se ka pasur shkelje në procedurën e zgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv.

M.Beqa: Për këtë ka një vendim Bordi dhe ankimi bëhet në Gjykatë.

E.Smaci: Unë votoj kundër pranimit të rendit të ditës për marrjen në shqyrtim të materialit mbi librin e Postribës. Do ta argumentoj kundërshtimin tim.

M.Beqa: Pse jeni kundër?

E.Smaci: E kam thënë që në korrik se nuk pranoj diskutim mbi libra të gatshëm pa asnjë pikë orientimi. Jam e skandalizuar nga mënyra se si relacioni që na erdhi nga Drejtori është jashtë çdo etike profesionale. Kam shumë respekt për drejtuesin e Këshillit Shkencor, por nuk mund të më dërgohet materiali pa firmën e tij, me arsyetimin se është jashtë Tiranës. Nuk do të pengoja asgjë po të kisha dokumentacionin përkatës të marrëveshjes me Fondacionin "Konrad Adenauer" dhe jam që kjo pikë të mos futet në rendin e ditës.

M.Beqa: Ka më kundër?

N.Mulleti: Mangësia qëndron te përgatitja për mbledhjen. Afatet duhet të na lejojnë që të jemi të përgatitur dhe të shmangim keqinterpretimet. Dokumentet duhet të jenë të plota dhe të nënshkruara nga Drejtori.

M.Beqa: Këto mund t'i përfshijmë në Rregullore ose të marrim një vendim si Bord. Jeni dakord?

M.Beqa: Unë propozoj që të merremi me rregulloren e Bordit në mbledhjen e parë të muajit janar. Jeni dakord?

Anëtarët e Bordit janë dakord.

M. Beqa: Të vijojmë me diskutimin e pikës 1, për buxhetin. Keni mendime?

V. Tole: Unë i shqyrtova materialet dhe nuk jam dakord vetëm për një projekt, konkretisht ekspozita “*Persekutimi i firmëtarëve të deklaratës së pavarësisë*”, pasi del jashtë viteve të juridiksionit të ISKK-së, për shkak se përfshin një periudhë që nuk është e përcaktuar me ligj. Për pjesën tjetër jam dakord.

N. Mulleti: Në relacionin e mbledhjes së kaluar ishte i përfshirë edhe Sondazhi.

Z. Graci: Projekti i Sondazhit ishte përgatitur i detajuar për të marrë fonde shtesë, mbi limitin e shpenzimeve operative që kemi përgatitur sot, ndaj nuk është përfshirë në këtë pjesë.

Ç. Hoxha: Do të propozohet sërish në muajin prill, ku do të kerkojmë për buxhet ekstra.

A. Liço-Gjurgji: Plani është ambicioz dhe nuk kam asgjë kundër, por a i ka ISKK kapacitetet për realizimin e tij? Për mua, pjesa më e rëndësishme është ajo me Ministrinë e Arsimit, që të ketë impakt për brezin e ri dhe për shkollat. Projekti për udhëzuesin është i madh; si e keni menduar organizimin e burimeve profesionale? Gjithashtu, më duhet një analizë e planit të mëparshëm për të parë si kanë ecur dhe në janar të kemi analizën gati për Bordin.

L. Roshi: Për vrasjet në kufi, një cikël pune të madh e ka bërë AIDSSH. Çfarë do të bëjë ISKK si institucion? Shoh edhe emrat e punonjësve që janë të punësuar këtu dhe që do të jenë pjesë e grupeve të punës, ndaj pyes se pjesa tjetër e buxhetit për kë do të përdoret. Për pjesën e pagesave të biletave të konferencave, kjo është jo ligjore. Do të doja që këto të dhëna të ishin pasqyruar në një matricë në janar, për të parë se kush i përfiton këto fonde. Për pjesën tjetër jam dakord. Kam këmbëngulur për vizibilitetin e ISKK-së, bashkëpunimin me median dhe promovimin e punës suaj. Shpresoj që kjo të përcillet siç duhet dhe, për janar, dua emrat që janë të përfshirë në strukturë.

Bordit i vihet në dispozicion marrëveshja me Fondacionin “Konrad Adenauer”.

E. Smaci: Mungesa e materialeve sjell keqinterpretime. Jam hezituese, veçanërisht për marrëveshjen me Konrad Adenauer, lidhur me pikën e konfidencialitetit të materialit. Në rastin e ISKK-së duhet të ketë transparencë dhe materialet t’i vihen në dispozicion Bordit, që të jemi sa më të qartë. Buxheti, me ndërhyrjet e bëra, është bërë i pranueshëm, por ka problem me ideimin e konferencave ndërkombëtare dhe botimeve. Të paguhen hotel dhe bileta për 15 persona është e papranueshme.

M. Beqa: Kjo është një praktikë ndërkombëtare që ndiqet për organizimin e konferencave dhe është çështje zgjedhjeje, nëse konsiderohet e arsyeshme apo jo.

E.Smaci: Unë jam që të ndryshohen shpenzimet e konferencave dhe votoj kundër. Sa i përket botimeve, ISKK është aset kombëtar dhe nuk i përket vetëm disa personave që kanë vuajtur nga regjimi. Emrat janë të autorëve që kanë botuar edhe më parë. Pse nuk ka autorë të tjerë dhe cila është procedura që ndiqet për ata që aplikojnë për botime? ISKK nuk po zgjerohet dhe kemi të njëjtët emra, të cilët e kanë shteruar historinë e tyre. Edhe për këtë arsye votoj kundër. Së fundi, për pjesën e infrastrukturës tek 231-shi, gjendja mbetet në nivel modest. Një rekomandim: të fillohet të mendohet për burime të tjera financimi dhe për dixhitalizimin e arkivës. Që buxheti të jetë funksional, çdo drejtori duhet të sjellë detajet e planifikimit përkatës. Institutit i ka përfunduar strategjia zhvillimore. Konstatimet për buxhetin janë: të mos ketë buxhete abuzive me një numër personash pa detajimin e punës që kryejnë; të mos jenë të njëjtët persona që realizojnë botimet; të rishikohet procedura e pranimin të botimeve; dhe të krijohet një strategji e re që do të planifikojë edhe buxhetet për vitet e ardhshme. Sa i përket planit, të ketë disa ripunime dhe një balancë midis drejtorive, në mënyrë që çdo punonjës ta gjejë veten në planin e punës.

M. Beqa: Me shumicën e vërejtjeve jam dakord. Planin e punës për vitin 2027 e duam brenda muajit shkurt. Analiza duhet të përgatitet në janar, që të kontribuojmë konkretisht me propozime. Jam dakord edhe me shpërndarjen e projekteve, në mënyrë që të përfshihen sa më shumë punonjës. Ndaj mendimin për një procedurë transparente për pranimin e botimeve. A ka një procedurë që është ndjekur deri më tani?

Ç.Hoxha: Ka një procedurë dhe hapa të përcaktuar që ndiqen. Shpallja bëhet në faqen e internetit (web), së bashku me udhëzimet përkatëse. Materialin do t'jua vë në dispozicion me e-mail. Ne jemi të hapur për këdo që aplikon. Sa i përket kapaciteteve, ato janë marrë në konsideratë, pasi puna është voluminoze dhe mendojmë se do të realizohet. Për çështjen e angazhimit të personelit, kjo është kompetencë ekzekutive e Drejtorit. Ne, në një fazë të dytë, hartojmë planin metodologjik me ngritjen e grupeve të punës përkatëse.

M.Beqa: Mund t'i sillni këto edhe në një matricë të veçantë në janar.

Ç.Hoxha: Për vrasjet në kufi kemi botuar një libër. Duhet të mblidhen dokumentet ekzistuese në arkiva dhe, mbi bazë dokumentare, të krijohen dosje dhe të botohen në të ardhmen dokumentet e plota, të cilat mund të përdoren edhe për arsye juridike.

E.Smaci: Do të ishte mirë që të na vihet në dispozicion edhe strategjia e mëparshme. E di që ka një vendim për këtë dhe është e nevojshme që të njihemi edhe ne si Bord.

M.Beqa: A i mbyllim diskutimet për planin dhe e miratojmë sot, apo në janar?

L.Roshi: Në janar.

A.Lico-Gjurgji: Për mua është në rregull.

S.Mirakaj: Edhe për mua.

N.Mulleti: Thjesht të bëhen ndryshimet e kërkuara; për pjesën tjetër jam dakord.

E.Smaci: Unë do të miratoj vetëm zërin e pagave dhe sigurimeve shoqërore, ndërsa për pjesën tjetër votoj kundër.

V.Tole: Mendoj njësoj si Znj. Etleva.

M.Beqa: Kemi dy dokumente: planin dhe buxhetin. Kush është dakord me miratimin e planit të punës?

V.Tole: Me planin jam dakord, përveç zërit të Ekspozitës i cili del jashtë juridiksionit të ISKK, siç e kam theksuar edhe më parë.

Vota pro (5): Mentor Beqa, Alma Liço-Gjurgji, Simon Mirakaj, Niuton Mulleti, Vasil Tole.

Vota kundër (2): Etleva Smaçi, Laureta Roshi.

M. Beqa: Plani i Punës miratohet. Kush është dakord me miratimin e buxhetit?

Vota pro (4): Mentor Beqa, Alma Liço-Gjurgji, Simon Mirakaj, Niuton Mulleti.

Vota kundër (3): Etleva Smaçi, Laureta Roshi, Vasil Tole.

Shënim: Znj.Zoica Graci në këtë moment largohet nga mbledhja. Bordit i vihet në dispozicion kontrata me Fondacionin "Konrad Adenauer".

M. Beqa: Buxheti miratohet. Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, që është kërkesa për miratim për botimin e librit "*Dokumente për Kryengritjen e Postribës 1946–1948*".

L.Roshi: Nuk kam kundërshtime.

A. Liço-Gjurgji: Lidhur me botimin, është një projekt që na ka ardhur i gatshëm dhe këtë herë jam dakord. Për botimet e ardhshme kemi dhënë mendimet tona për mënyrën se si duhet të procedohet. Personat që kanë hartuar recensën janë specialistë të fushës dhe argumentimi i tyre thekson rëndësinë e ngjarjes.

E.Smaci: Do të kisha preferuar që, si njohëse e periudhës, recensën ta bënte anëtarja e Këshillit, Znj. Enriketa Papa, si njohëse e fushës. Kontratën me Konrad Adenauer mund ta kishit dërguar paraprakisht me e-mail, së bashku me relacionin, pasi kam ngritur shqetësimin nga ana financiare. Procedura duhet të bëhet siç duhet, me dy recensa, dhe ju në Këshill keni dy profesorë të fushës, ndaj gjërat duhet të bëhen me rregull. Duhet të jeni më të kujdesshëm, pasi është një ngjarje shumë sensitive.

Ç.Hoxha: Redaktimi është kryer nga z. Ardian Muhaj, si ekspert i fushës dhe njohës i zonës, dhe është realizuar në mënyrë shumë të mirë, përfshirë edhe trajtimin e emrave, të cilët nuk kanë mbiemra. Kjo është çështje dokumentacioni.

N.Mulleti: Parimisht jam dakord me Znj.Etleva, pasi kemi dy profesorë të nderuar në Këshill dhe do të ishte më korrekte. Megjithatë, kjo nuk e zhbën procesin. Jam dakord për miratim dhe për raste të ngjashme në të ardhmen, duhet të ketë një standard më të lartë.

M. Beqa: Jemi dakord për miratimin?

Anëtarët e Bordit janë dakord.

M. Beqa: Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me kërkesën e Nënkryetares Laureta Roshi për përgjigjen e Kuvendit lidhur me procedurën e zgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv të ISKK-së.

Shënim: Ora 10:20, Drejtori Ekzekutiv i ISKK Çelo Hoxha largohet nga mbledhja.

L.Roshi: Ne kemi kaluar në proces votimi pa pasur në dispozicion CV-të e printuara. Procedura ka qenë e përshpejtuar dhe pa pasur njohuri për elementet e rinj që kanë dalë më pas. Kam reaguar edhe më parë kur kam kërkuar shtyrjen e afatit për mbledhjen e kandidaturave, por nuk keni qenë dakord me arsyetimin se nuk kishim kohë ligjore. Unë kërkoj lirim nga detyra të Drejtorit Ekzekutiv, shpalljen e një njoftimi të ri dhe rikandidimin, duke përfshirë në CV edhe elementet që janë fshehur. Sipas shkresës së Kuvendit, është cenuar parimi i besueshmërisë. Nëpunësi duhet të jetë person që gëzon besueshmëri dhe nuk ka qenë i shkolluar apo nuk ka kryer kualifikime në shkollat e larta politike të sigurimit. Kjo shkresë na informon se kemi marrë një vendim të gabuar.

M.Beqa: Në cilën pjesë të shkresës thuhet se është marrë një vendim i gabuar?

L.Roshi: Është shkelur parimi i besueshmërisë, pasi Drejtori ka fshehur këtë fakt në CV-në e tij. Ky element duhet të ishte përfshirë dhe t'i paraqitej Bordit, pasi në të kundërt nuk do të ishte zgjedhur. Kërkesa ime është rishpallja e pozicionit të Drejtorit Ekzekutiv, pasi është provuar se Drejtori aktual ka fshehur fakte të rëndësishme që përbëjnë vepër penale. Unë dhe dy anëtarë të tjerë të Bordit kemi kërkuar sqarime pas votimit, pasi nëse këto elemente do të ishin bërë të ditura më herët, ai nuk do të ishte përfshirë fare në garë.

Kryetari i Bordit lexon shkresën me nr. 19161/2 Prot., datë 22.07.2025, "Kthim përgjigje", nga Kuvendi.

M.Beqa: Qartazi, në dy pika Kuvendi thekson se zgjedhja e Drejtorit është atribut i Bordit dhe ne kemi dalë me Vendim për zgjedhjen e Drejtorit të ISKK-së.

L.Roshi: Bordi e ka marrë vendimin pa pasur informacionin përkatës në rrugë zyrtare.

E.Smaci: Ajo që më shqetëson është se Z.Çelo e ka fshehur këtë fakt. Ky informacion ka ardhur pas votimit. Unë kam votuar kundër dhe këtë po e shpreh hapur sot. Ndërkohë, kemi edhe kandidatin tjetër, Z. Agim Baci, i cili ndodhet në proces gjyqësor për këtë çështje në Gjykatën Administrative. Si anëtarë e Bordit, kërkoj rifillimin e garës, pasi është fshehur një fakt shumë i rëndësishëm, në shkelje të nenit 18, pika 1/b, të ligjit për krijimin e ISKK-së.

L.Roshi: Edhe unë mbështes këtë kërkesë.

M. Beqa: Paraqitni kërkesën me shkrim; ajo do të përfshihet në rendin e ditës së mbledhjes së radhës dhe do të merret vendim në përputhje me ligjin.

V.Tole: Është një shans që na jepet për t'u rikthyer përgjegjesisë si Bord. Për mua, u nxorën në pah sepse nuk e sqaruam situatën, e cila përbën një kriter përjashtues. Sigurisht që vendos Bordi, por e shikoj të udhës që, nëse çështja do të bëhet publike, të kishte dy vendime: një vendim moral nga vetë Drejtori, që të jepte dorëheqjen dhe të na sqaronte situatën, dhe një vendim nga Bordi, nisur nga shkresa e Kuvendit, për rifillimin e garës. Unë i qëndroj idesë se ky është një kriter përjashtues dhe mendoj që votimi të kryhet në kushtet e reja.

M. Beqa: Nëse nuk ka më mendime, e mbyllim këtë pjesë dhe caktojmë një datë për mbledhjen e radhës.

Anëtarët e Bordit bien dakord për datën 20 janar 2026, ora 14:00.

Mentor Beqa.....

Simon Mirakaj.....

Etleva Smaçi.....

Loreta Roshi.....

Alma Lico-Gjurgji.....

Niuton Mulleti.....

Përpiloi: Franceska Loshe

